



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Istog
Skupština Opštine Istok
Municipal Assembly Istog

Komititeti për Politikë dhe Financa/Komitet za Politiku i Financije/ Policy and Finance Committee

Nr. 10	P r o c e s v e r b a l
Tipi i mbledhjes:	Mbledhje e Rregullt e KPF-së
Data e mbajtjes:	20.01.2023 në ora 10:00
Mbledhjen e kryesoi:	Enver Rugova, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Istogut dhe
Procesmbajtës:	Flora Bujupaj Asistente Administrative pranë zyrës së Kryesuesit të Kuvendit.
Pjesëmarrës anëtarët e KPF-së	Hajrush Shoshi, Faruk Kabashi, Liridona Lajçi, Ardit Idrizaj, Ajshe Metaj dhe Niman Beqiraj.
Mungojnë:	
Pjesëmarrës të tjera:	Kryetari i komunës, z. Ilir Ferati, nënkyetari i Komunës Ali Nimanaj. Drejtorët: Merita Muzlaj Bytyçi, Agon Dreshaj, Dukagjin Hoxhaj, Zenel Shatri, Naim Behlulaj Abedin Kabashi, Arben Kabashi, zyrtar administrativ: Ardon Arifaj OSCE Hysen Pelaj.

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar
2. Shqyrtimi i raportit finansiar për tre mujorin e katër, tetor-dhjetor 2022,
3. Shqyrtimi i raportit të punës së Kuvendit komunal për vitin 2022,
4. Shqyrtimi i raportit të punës së Kryetarit të komunës për vitin 2022,
5. Shqyrtimi i raportit të punës së KKSB-së për vitin 2022,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Planit të Veprimit për Transparencë 2023-2026
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Strategjia për Komunikim dhe Informim 2023-2026,
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Planit Komunal për Integritet 2023-2026,
9. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimit për Destinimin e pronës për varreza në fshatin Zhakovë,
10. Shpallja në Dëgjim Publik e Projekt Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në komunën

e Istogut,

11. Shpallja në Dëgjim Publik e Planit Strategjik për Trashëgimin Kulturore dhe Natyrore për komunën e Istogut 2023-2027,

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit -përshëndeti të pranishmit.

Konstaton të gjithë anëtarët e KPF-së janë prezent, kushtet janë plotësuar për mbajtjen e mbledhjes. Hapi punimet për këtë mbledhje me pikat e rendit të ditës të parapara për ditën e sotme.

Prezanton rendin e ditës,

Fton ekzekutivin si dhe anëtarët e KPF-së nëse dikush ka ndonjë pyetje sugjerim apo ndonjë propozim për rend dite?

Pasi që nuk ka vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës.

Kush është qe të miratohet rendi i ditës.

Miratohet unanim rendi i ditës së mbledhjes së sotme.

Prezent në mbledhje janë të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Vendimet:

Miratohet me shumicë votash rendi i ditës, me ketë propozim nga Ekzekutivi.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 1.

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit-Enver Rugova, vazhdojmë më pikën e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Prosesverbalju ka ardhur me vonësë, dhe ju kërkoj falje në emër të sekretarisë për shkak të vëllimit të madh të punëve, por gjithsesi e keni marrë, dhe ju pyes, ka dikush ndonjë vërejtje për procesverbalin?

Pasi qe nuk ka .

Hedh në votim, kush është qe të miratohet procesverbal nga mbledhja e kaluar?

Miratohet unanim procesverbal nga mbledhja e kaluar pa asnjë vërejtje.

Vendimet:

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Shqyrtimi i pikës 2.

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë më pikën e dytë të rendit të ditës: Shqyrtimi i raportit financier për tre mujorin e katër, tetor-dhjetor 2022,

Fjalën e ka zyrtari kryesor financier z. Osman Sadikaj.

Osman Sadikaj- përshëndet të gjithë të pranishmit dhe prezanton raportin financier për tre mujorin e katërt, tetor-dhjetor 2022.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapim debatin rreth kësaj pike të rendit të ditës? A ka kush diçka që dëshiron të diskutoj? Urdhëro Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Unë dua vetëm një sqarim te puna e përmbaruesit, a ka të drejtë ta marrë ai ku të do, apo duhet të ja caktoni ju?

Osman Sadikaj- çdoherë departamenti i thesarit ZKF-së, i dërgon së pari a po e pranon këtë borxh, së dyti a po pranon ku dëshiron të t'i marrë. Sa i përket kontratës kolektive komuna nuk është obligative të paguaj mjete, pa marrë parasysh nëse gjykata e ka sjellë një vendim të tillë, për arsy se në kontratë kolektive shkruan që të gjitha mjetet financiare që ndikojnë për kontratë kolektive, ministria e Arsimit ka obligim që edhe Shëndetësisë me qarkore buxhetore të ndaj buxhet të veçantë, asnjëherë nuk ka ndodhur ajo punë, kështu që unë nuk e kam pranuar si borxh asnjëherë, dhe i kam thënë nuk ta japë asgjë që nuk është obligim i komunës, ata e kanë marrë ku kanë pasur dëshirë.

Niman Beqiraj- është mirë p.sh nëse gjykata e ka vendosur që i takon komunës, të paktën me i treguar ne, me pranuar si borxh dhe me i treguar ku me i marrë, p.sh tanë kanë marrë mjete nga lumi i Istogut dhe tanë shih çfarë po na bëjnë reshjet.

Osman Sadikaj- lumi i Istogut ka qenë në fazën përfundimtare, nuk ka të bëjë me çështje të vërvshimeve, ne e kemi bërë kërkesën t'i marrim këto mjete sepse nuk kemi pasur mundësi ta realizojmë projektin, d.m.th janë marrë në fund këto projekte që nuk kanë pasur mundësi të realizohen sepse afati shkoi edhe tenderi është hapur, nuk ka mundur të lidhet kontrata. Ata e kanë një obligim i marrin nëpër kategoritë ekonomike.

Ajshe Metaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Desha të qasem tek përbartimi sepse është një temë që e kemi diskutuar shumë gjatë, u tha që totali i pagesës këtu janë disa mjete të pa shpenzuara pra këto veç kanë shkuar në suficit, e nuk i kanë kryer obligimet në disa shkolla, që ne ndër të parët kemi qenë ata që i kemi bërë këto ankesat, ose paditë, a kishte me qenë më mirë me e paguar me këto një borxh sado të vogël e mos të shkojnë në suficit.

Osman Sadikaj- në të gjitha shkresat që i ka sjellë departamenti i thesarit para vitit fiskal, e që para katër ditëve ka ardhur një shkresë tjetër, për obligimet që kanë mbetur, të gjithë drejtoret e kanë një listë që ua kam dërguar, tanë me buxhetin që fillon paguhën ato, sepse nuk e kemi pasur ne këtë listë para vitit të ri, që d.m.th te presim pasi që ajo do të paguhet nga ky buxhet.

Ajshe Metaj- desha të lidhem te këto projektet që janë marrë mjetet për me i bërë këto pagesa, komuna si komunë asnjëherë nuk e ka pranuar që është borxh i saj, mirëpo po duhet ta paguaj. Se di a është më mirë që ato projekte që mund te presin dhe te orientohet nga disa projekte që janë me më shumë urgjencë që ata i kane marrë, sepse tregu i gjelbër është mandati i dytë qe po përmendet që duhet te rregullohet e nuk bëhet asgjë, ose drenazhimi ose mburojat e stadiumit, dëmi shkaktohet nëse nuk realizohet në kohë, sepse e di që bëhet më me vonesë.

Osman Sadikaj- të gjitha këto projekte 190 mijë euro nuk kanë pasur të realizohen, këto tri projekte që i përmenda nuk kanë pasur mundësi të realizohen, më mirë me paguar obligime se sa me shkuar në suficit.

Ajshe Metaj- te lista e punëtorëve i kam disa fjalë. E kemi diskutuar bashkërisht listën e vendeve të lira, marrë parasysh kushtet dhe rrethanat si dhe inflacionin, sa ka mundësi të plotësohen këto vende të punës?

Osman Sadikaj- është e vërtetë që deri në fund të vitit ka bërë disa ndryshime edhe ministria, tanë është ministria e Punëve të Brendshme, departamenti i administratës dhe në kuadër të saj divizioni i pagave. E kanë bërë një softwer për plotësimin e të dhënave dhe ne kemi shpallur bukur shumë disa konkurse sepse ka qenë pengesë e madhe shpallja e konkurseve, ne e kemi autonominë zero pa i plotësuar të gjitha kriteret, ministria përkatëse nuk të jep mundësi për shpalljen e konkurseve. Kështu që shumë shpejt këto vende të punës do të mbulohen.

Ajshe Metaj- e në sektorin e Arsimit?

Osman Sadikaj- në sektorin e Arsimit është problem me i plotësuar në shpejtësi. Arsimi është shumë në rregull në raport me si ka qenë, vendet plotësohen, e njejtë është edhe në shëndetësi, kryetari është i njoftuar shumë mirë për këtë.

Kryetari i komunës- Përshëndet të gjithë të pranishmit! Një plotësim shumë të shkurtër, te shëndetësia te kujdesi primar i kemi plotësuar nëse nuk gaboj janë katër mjekë me kontratë të përhershme nga viti i kaluar, një teknik i laboratorit, një juriste, një teknik infermier dhe një infermiere. Te Arsimi në gjithë vitin e kalon numrin 100 profesoreshë, me kontrata te rregullta me plotësime me zëvendësime. Këtë vit do të plotësohen edhe vende të tjera te punës.

Kryesuesi i Kuvendit- a ka edhe dikush që dëshiron të diskutoj rrëth kësaj pike të rendit të ditës? Hajrush Shoshi.

Hajrush Shoshi- përshëndet të gjithë të pranishmit! Janë shumë mjete që kanë mbetur prej projekteve, janë diku rrëth 128 mijë euro, në të ardhmen kishte me qenë mirë që këto mjete te rialokohen dhe të paguhen borxhe që kanë ndodhur këtë vit. Janë diku rrëth 18 projekte që nuk janë proceduar fare.

Kryesuesi i Kuvendit- Kryetari i komunës e ka fjalën.

Kryetari Komunës- vërejtje të ngritura shumë me vend, nuk është se nuk kemi mundur ta bëjmë një rialokim me një vendim, po çfarë po na penalizon pastaj është rapporti i Auditorit, për grantin sa i përket rapportit të përfomancës. Listën e projekteve me qenë unë në vend të juajin si anëtar i Kuvendit, i kisha gozhduar drejtorët që nuk I kanë inicuar publikisht në mbledhje të Kuvendit, me qenë të njoftuar saktë, për arsyet pse nuk janë inicuar, do kisha qenë krah i juaji këtu.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit kryetar, po na ndihmon edhe si Komitet por edhe si Kuvend. A ka edhe dikush diçka? Atëherë e hedhim në votim.

**Kush është për, hedh në votim
Miratohet unanim dhe i njëjti i kalohet kuvendit
Shtatë anëtarë prezent në mbledhje.**

Vendimet:

Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim miraton Raportin finançiar për tre mujorin e katër, tetor-dhjetor 2022,

Personat përgjegjës për zbatim:

Shërbimi për punë të kuvendit

Afatı për zbatim:

Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 3.

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë më pikën e tretë të rendit të ditës, Shqyrtimi i raportit të punës së Kuvendit komunal për vitin 2022, duhet ta jap një ekzaminim të vogël sa i përket raportit të punës së Kuvendit, rezultati ka qenë ai që është në raport, i përfshirë në pika të shkurtëra, faleminderit për kontributin e juaj të kryetarit dhe ekzekutivit.

A ka dikush diçka rrëth kësaj? Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- unë i përshëndes të gjitha këto, që në fakt ishin. Dua ti preku disa pika, kur është fjala te komisionet konsultative që janë zgjedhur, pra ju ka përfunduar mandati, dhe a duhet të zgjedhen prapë sepse në raport thuhet që ju ka përfunduar mandati në vitin 2022. Dhe te dëgjimet publike besoj që nga këto mund të marrim përcaktimin e prioriteteve të projekteve që duhet të realizohen, pra pjesëmarrja e qytetarëve në dëgjime publike nuk është e kënaqshme, çfarë mund të bëni që mund të ndryshoj kjo? Si dhe pika tjetër ka të bëj me vlerësimin e ligjshmërisë së rregulloreve që faktikisht kemi përvoja që po na kthehen dhe vonohen, çfarë mund të bëjmë që të jemi më të vëmendshëm, që mos te kthehen, që mos të vonohet aplikimi i tyre.

Kryesuesi i Kuvendit- e nderuar sa i përket komitetave konsultative është obligim i ekzekutivit me kuvendin që të formohen, legjislaturat e kaluara, jo kjo e parafundit, por edhe më parë kanë filluar ti formojnë komitetet konsultative, këto janë me mandat 4 vjeçar, ju ka përfunduar mandati në dhjetor të vitit të kaluar, ne e kemi komitetin konsultativ për persona me nevoja të veçanta, dhe për atë arsy kemi pritur që ti bëjmë bashkë dhe ti hapim konkurret, sa i përket pjesëmarrjes së qytetarëve në dëgjime publike, është sfidë në gjithë Kosovën, ndërsa te vlefshmëria e ligjshmërisë, kuvendi e ka përformancën diku me gjithë parametrat 94%, puna e kuvendit komunal që fatkeqësisht mandatin e kaluar nuk ka qenë, së paku vitin e fundit, tanjë jemi këtu të gjithë së bashku, për disa kthime të vendimeve kanë pasur arsy për disa kanë qenë të bazuara fort në ligj, edhe nuk e di pse janë kthyer, le të janë të kaluara, ka vend për përmirësimë.

Kryesuesi i Kuvendit- pasi që diskutime tjera nuk ka, hedh në miratim këtë pikë të rendit të ditës.

**Miratohet unanim dhe i njëjti i kalohet kuvendit
Shtatë anëtarë prezent.**

Diskutimet:	
Vendimet:	
Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim miraton Shqyrtimi i raportit të punës së Kuvendit komunal për vitin 2022,	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 4.

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit-po vazhdojmë më pikën e katërt të rendit të ditës, Shqyrtimi i raportit të punës së Kryetarit të komunës për vitin 2022,

A dëshiron dikush të diskutoj rreth kësaj pike?

Kryetari i komunës- shumica e punës në atë raport, ka qenë pjesë këtu dhe pjesa tjetër është e publikuar në faqe zyrtare, kush ka pyetje le të urdhëron.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit kryetar, a ka dikush tjetër që dëshiron të diskutoj.

Ajshe Metaj- përgëzon punën e kryetarit dhe ekipit të tij, sepse sa herë ka raste emergjente angazhohet, vetëm e kam një pyetje a ka dëme të mëdha në komunën tonë nga vërvshimet?

Kryetari i komunës- te ne në Istog, gjendja është me e lehtë se sa në Mitrovicë dhe Skenderaj që ka pasur vërvshime, pjesa ku ka pasur përmbytje më shumë ka qenë në Rakosh, Kërrnina Osejan, Drejë, Lugu i Drinit, posaçërisht pjesa nga Prigoda. Si zonë më e rrezikshme ka qenë Dreja, ku janë evakuuar 42 persona me ndihmën e ekipeve të shpëtimit. Dëmet janë të mëdha në këto pjesë që i përmenda, edhe në shtëpia, në infrastrukturë, në objektet e QKMF-së në objektet e arsimit, në sistemin e ujit të pijes, të kanalizimit, besoj që deri ditën e mërkurë do dalim me një listë preliminare ku u dakorduam me kryeministrin të cilin shfrytëzoj rastin ta falënderoj publikisht për vizitën që na ka bërë, dhe të na krijohet një kod ekonomik në të cilin mund të derdhen mjetet në mënyrë që këta njerëz më bërë të banueshme prapë shtëpitë e tyre.

Niman Beqiraj-unë me të vërtetë dua t'i falënderoj të gjithë akteret që kanë qenë te përfshirë në këtë punën e vërvshimeve dhe ja keni dalë bashkërisht, por kishte me qenë mirë që emergjencave me ja paraprirë pak, se ne normal vërvshimet nuk mund t'i ndalim, por mundemi t'i minimizojmë dëmet, nëse i pastrojmë lumenjtë, përroskat dhe të mirëmbahen ato, sigurisht tejkalohet më lehtë dhe do ketë më pak probleme. A keni ndonjë plan për punën e vërvshimeve që në të ardhmen mos t'i kemi dëmet e njëjta dhe të jenë më të vogla. Faleminderit!

Kryetari i komunës-shkaktari kryesor i pjesës ku kanë filluar vërvshimet ka qenë shkarkimi i lumbit i cili ka qenë i pastruar, por sasia e ujit ka qenë aq e madhe sa as shtrati i Drinit të bardhë nuk do e kishte përballuar. Te plani jonë për parandalim i pari është betonimi i kanalit të lumbit "Qaush" i cili po i shkakton dëmet më të mëdha sepse është në qytet. Te pjesa e pastrimit të lumbit të Istogut është projekt milionësh i detajuar, thjeshtë po presim sinjalin e parë prej donatorëve, është projekt i madh edhe për qeverinë. Brenda mandatit për presionin që jemi duke e shtuar, ka me filluar puna e pastrimit, po ashtu po synojmë një pjesë të shumës së grantit të pëformancës ta shpenzojmë në

pastrimin e kanaleve të ujites.

Kryesuesi i Kuvendit- a dëshiron edhe dikush të marrë fjalën? Atëherë kush është që kjo pikë e rendit të ditës të procedohet në Kuvend?

Hedh në miratim:

Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së.

Shtatë anëtarë prezent.

Vendimet:

Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ia kalon Kuvendit të Komunës pikën e rendit të ditës Shqyrtimi i raportit të punës së Kryetarit të komunës për vitin 2022,

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 5.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdojmë më pikën e pestë të rendit të ditës, Shqyrtimi i raportit të punës së KKSB-së për vitin 2022.

Fjalën e ka Skender Hasangjekaj, përshëndet të gjithë të pranishmit, dhe prezanton raportin e punës së KKSB-së për vitin 2022.

Kryesuesi i Kuvendit- A dëshiron dikush të diskutoj rreth kësaj pike? Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- Shpresoj që është vetëm gabim teknik dhe përbajtja e këtij rapporti nuk është ajo e viti të kaluar. Te e drejta në punë, te sektori privat çfarë keni ndërmend të ndërmerrni lidhur me punëtorët për shkak se janë të nënvlerësuar në shumë aspekte. Dhe te dukuritë negative, dua ta di çfarë është punuar në këtë drejtim që të eliminohen dukuritë negative sidomos në shkolla, marrë parasysh nxënësit të cilët ekspozohen dhe abuzojnë shumë herët sidomos me narkotikë. Sa keni kërkuar që në këtë drejtim të punohet?

Niman Beqiraj- ju falënderoj për punën që e keni bërë gjatë këtyre ditëve, sidomos te puna e vërvshimeve. E kam një pyetje rreth punës që po më duket e pamjaftueshme qe sa i përket vërvshimeve me e kontaktuar vetëm kompaninë rajonale për mirëmbajtjen e kanaleve. Është më mirë të thirren më shumë akter sepse është problem që ndodhë pothuajse çdo vit. Ju përgëzoj që e keni marrë përsipër vendosjen e kamerave nëpër fshatrat ku pa pasur vjedhje të mëdha, edhe ju inkurajoj që të vazhdoni kështu edhe nëpër fshatrat e tjera. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- Enver Rugova, a ka edhe dikush diçka tjetër?

Skender Hasangjekaj- ju thashë që është gabim teknik, dhe vërtetoheni tek faqja zyrtare e komunës që janë të gjitha materialet e publikuara. Është e drejtë ekskluzive e inspektoratit të punës që të merret me të punësuarit e ne veçanti të sektorit privat. Ju kemi bërë thirrje, kanë qenë, kanë inspektuar, sa i përket temës do ta elaborojmë kur të vijnë dhe të bëjmë debat. Siguria që e përmende, ne kemi bërë edhe takime në vitin paraprak, kemi pasur konsulent që merret me këto

tema të drogave dhe narkotikeve në nivel shkolle, ka shpreh gatishmëri të mbaj ligjërata në çdo shkollë, por duhet kompensim dhe nuk kanë mjete ta bëjnë. Nga ana tjetër nga ministria e punëve të brendshme, ekziston një plan operativ që në të gjitha shkollat, zyrtarët nga kjo ministri, policia e Kosovës mbajnë ligjërata në çdo shkollë sa i përket temave të narkotikëve. Çështja tjetër e sigurisë së shkollave sipas drejtorit të arsimit që i ka raportet javore dhe mujore nga drejtorët e shkollave, gjendja në vitin 2022 ka qenë relativisht e mirë. sa i përket pyetjes për vërvshime, kompetencat që janë brenda administratës komunale, në veçanti secila drejtori në fushën e vet, por jashtë institucionit ajo që në të kaluarën ka pasur pasoja në vërvshime, kanë qenë pikërisht digat për të cilat kompetente është kompania rajonale "Drini i Bardhë" dhe për këtë qellim të parandalimit në fazën kur kryhen ujitjet e tokave bujqësore në mënyrë që ata të marrin digat dhe mos të krijojnë vërvshime. Brenda administratës ka rapportuar drejtori i Bujqësisë i Shërbimeve publike, dhe ai i Emergjencave sepse kemi përgjegjësi administrative në këto lëmi. Investimet në këto parandalime janë shumë të mëdha. Ato mjete që i kemi i investojmë. Kaq, nëse ka dikush diçka, urdhëroni.

Kryesuesi i Kuvendit- ju faleminderit!

Pasi që nuk ka diskutime, hedh në votim

Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së.

Gjashtë anëtarë prezant.

Diskutimet:

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejtje dhe diskutime, KPF-ja rekomandon që: pika e rendit të ditës 'Shqyrtimi i raportit të punës së KKSB-së për vitin 2022. t'i kalohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim.

Personat përgjegjës për zbatim:

Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:

Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 6.

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë më pikën e gjashtë të rendit të ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Planit të Veprimit për Transparencë 2023-2026. A e dëshiron dikush fjalën lidhur me këtë pikë të rendit të ditës?

Arben Kabashi- prezanton pikën e rendit të ditës , cili Draft -Plan ka kaluar në të gjitha procedurat para miratimit të saj.

Kryesuesi i Kuvendit – pasi që diskutime tjera nuk ka. Kush është për që kjo pikë e rendit të ditës të procedohet në Kuvend?

Hedh në votim

Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së.

Shtatë anëtarë prezant.

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejtje dhe diskutime, KPF-ja rekomandon që pikë e rendit të ditës 'Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Planit të Veprimit për Transparency 2023-2026 t'i kalohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 7**Diskutimet:**

Kryesuesi i Kuvendit- po vazhdojmë më pikën e shtatë e rendit të ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Strategjia për Komunikim dhe Informim 2023-2026,

Arben Kabashi- prezanton pikën e rendit të ditës , njëjtë po ashtu edhe ky Draft- Plan ka kaluar në të gjitha procedurat para miratimit të saj.

Kryesuesi i Kuvendit – pasi që diskutime tjera nuk ka. Kush është për që kjo pikë e rendit të ditës të procedohet në Kuvend?

Hedh në votim

Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së.

Shtatë anëtarë prezent.

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejtje dhe diskutime, KPF-ja rekomandon që pikë e rendit të ditës 'Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Strategjia për Komunikim dhe Informim 2023-2026, t'i kalohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 8**Diskutimet:**

Kryesuesi i Kuvendit- po vazhdojmë më pikën e shtatë e rendit të ditës, Draft-Planit Komunal për Integritet 2023-2026

Arben Kabashi- prezanton pikën e rendit të ditës , njëjtë po ashtu edhe ky Draft- Plan ka kaluar në të gjitha procedurat para miratimit të saj.

Kryesuesi i Kuvendit – pasi që diskutime tjera nuk ka. Kush është për që kjo pikë e rendit të ditës të procedohet në Kuvend?

Hedh në votim

Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së.

Shtatë anëtarë prezent.

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejtje dhe diskutime, KPF-ja rekomandon që pikë e rendit të ditës 'Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Planit Komunal për Integritet 2023-2026 t'i kalohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës pér zbatim:	Shërbimi pér punë të kuvendit
Afati pér zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 9

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit, po vazhdojmë më pikën e nënt të rendit të ditës Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimit pér Destinimin e pronës pér varreza në fshatin Zhakovë.

Nënkyetari i komunës- parcela e kaluar pér të cilën është marrë vendim në Kuvend pér varrezaz në fshatin Zhakovë, është nga pjesa e Rakoshit, ndërsa kjo sot është kërkesë e pjesës së lartë të Zhakovës, është kërkesë e qytetarëve si e mirë e fshatit që ajo të destinohet pér varreza. Pér detaje drejtori është këtu dhe na e prezanton më në detaje.

Agon Dreshaj- përshëndet të gjithë të pranishmit, dhe prezanton pikën e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit- a ka më pyetje rreth kësaj pike? Hajrush Shoshi është lajmëruar.

Hajrush Shoshi- vetëm desha t'i them drejtorit që do ishte mirë t'i bashkëngjitej çertifikata e pronës dhe kopja e planit.

Agon Dreshaj- po do t'i bashkëngjitet.

Kryesuesi i Kuvendit- kush është që kjo pikë të procedohet në Kuvend?

Hedh në votim

Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së.

Shtatë anëtarë të pranishëm

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejtje dhe diskutime, KPF-ja rekomandon që pika e rendit të ditës ' Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimit pér Destinimin e pronës pér varreza në fshatin Zhakovë t'i kalohet Kuvendit të Komunës pér shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës pér zbatim: **Shërbimi pér punë të kuvendit**

Afati pér zbatim: **Deri në mbledhjen e kuvendit**

Shqyrtimi i pikës 10

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit- po vazhdojmë më pikën e dhjetë të rendit të ditës 'Shpallja në Dëgjim Publik e Projekt Rregullores pér Menaxhimin e Mbeturinave në komunën e Istogut. Fjalën e ka nënkyetari i komunës.

Nënkyetari i komunës- është drejtori i Shërbimeve Publike që mund t'i prezantoj shkurtimisht pasi që do dalë në dëgjim publik.

Abedin Kabashi- përshëndet të gjithë të pranishmit dhe prezanton pikën e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit- pasi që diskutime tjera nuk ka

Hedh në votim

Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së.

Shtatë anëtarë të pranishëm.

Vendimet:

Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ai kalon Kuvendit të Komunës pikën 'Shpallja në Dëgjim Publik e Projekt Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në komunën e Istogut.

Personat përgjegjës për zbatim:

Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:

Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 11

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit- po vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës 'Shpallja në Dëgjim Publik e Planit Strategjik për Trashëgimin Kulturore dhe Natyrore për komunën e Istogut 2023-2027.

Ju kisha lutar për mirëkuptim që ta votojmë këtë rregullore të shkojë në Kuvend, pastaj drejtoresha si inicuese do ta prezantoj në Kuvend. Kush është për?

Hedh në votim

Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së.

Shtatë anëtarë të pranishëm.

Vendimet:

Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ai kalon Kuvendit të Komunës pikën 'Shpallja në Dëgjim Publik e Planit Strategjik për Trashëgimin Kulturore dhe Natyrore për komunën e Istogut 2023-2027.

Personat përgjegjës për zbatim:

Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:

Deri në mbledhjen e kuvendit

Verejtje :

Kryesuesi i kuvendit, pasi që përfunduan pikat për këtë rend dite, falënderoj për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë.

Shpalli të myllura punimet për këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoj : 12:13

Procesmbajtëse,
Znj. Flora Bujupaj

Kryesuesi i Kuvendit,
z. Enver Rugova

